

FINCA Kosovë është Institucion Mikro Financiar, që operon në Euroazi, Lindje të Mesme, Afrikë dhe Amerikë Latine, shpall:

FTESË PËR OFERTË

Institucioni Mikrofinanciar FINCA Kosovë, fton të gjitha Kompanitë e interesuara që të ofertojnë për Tenderin në vijim:

“Furnizim me ujë të pijes të ambalazhuar në të gjitha zyret e FINCA Kosovës” me numër të prokurimit FINCA-100/26-1 Perseritje

Të interesuarit mund ti marrin specifikacionet për aplikim prej datës 03 Janar 2026 në web faqe të FINCA Kosovës www.fincakosovo.org, ne likun zyrtar <https://fincakosovo.org/tenders/> ose përmes emailit zyrtar në: ks.procurement@fincakosovo.org.

Vërejtje:

- Malli dhe / ose shërbimet duhet të jenë me kualitet të lartë dhe me çmime të volitshme, TVSH-ja duhet të jetë e përfshirë brenda çmimit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë dy muaj (60 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Çmimet kuotohen për njësi në Euro (€).
- Eksperiencia e ofertuesit për punë të ngjashme (të bashkangjiten së paku tre referenca nga Institucionet me reputacion në Kosovë të cilat vërtetojnë se Ofertuesi ka kryer punë të ngjashme ashtu si parashihet në Kontratë).
- Adresa e plotë dhe detajet për kontakt të Ofertuesit.
- Secila faqe duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga Drejtori i Kompanisë.
- FINCA Kosovë mban të drejtën për të bërë ndryshimin në specifikacion, të anulojë këtë Tender, të riftojë pjesëmarrësit individual për të riparqitur ofertën e tyre, të diskualifikojë një ofertues pa dhënë njoftim apo arsye.
- Ofertat të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë dokument, mund të diskualifikohen nga procesi i përzgjedhjes.
- Asnjë shpenzim që bëhet gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kuotimit të cmimit nuk do të kompenzohet nga FINCA Kosovë.
- Kriteret për përzgjedhje në këtë Tender bazohen në vendimin e Komisionit për Tender dhe të Bordit Menaxhues.

Oferta mund të dërgohet në formë fizike dhe në formë elektronike:

- **Oferta në formë fizike** të dorëzohet në Zyrën Qendrore të FINCA Kosovës (Robert Doll Nr.112, Prishtinë).
- Oferta e dërguar në formë fizike duhet të jetë në zarf të mbyllur me pershkrim të qartë „për Departamentin e Administratës dhe me numer të Tenderit .
- **Oferta në formë elektronike** të dërgohet në email adresën zyrtare në ks.procurement@fincakosovo.org
- Ofertat e dërguara përmes postës elektronike duhet të jenë të mbrojtura me fjalëkalim.
- Fjalëkalimi duhet të dërgohet, me kërkesen tone ose 48 orë pas mbylljes së afatit për dorëzimin e ofertave (10 Shkurt 2026).
- Ofertat e pambrojtura me fjalëkalim, do të shpallen të pavlefshme.

Për informata shtesë ju lutemi kontaktoni përmes emailit në: ks.procurement@fincakosovo.org

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është e marte, 10 Shkurt 2026 në orën 16:00.

FINCA Kosovë, Robert Doll 112, 10000 Prishtinë

FINCA Kosovë Zyra Qendrore Rr. Robert Doll, Nr.112 10000 Prishtina + 383 (0) 38-609-721 + 383 (0) 38-609-722 Kosovo.FINCA.org

